



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 757/1 Prot.

Tiranë, më 01 / 06 / 2021

V E N D I M

Nr. 96 , Datë 01 / 06 / 2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 147 Regj., datë 07.12.2020, të E. B, kundër Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), me pretendimin e diskriminimit për shkak të “gjendjes arsimore”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, E. B, ka përfunduar studimet e larta universitare, zotëron diplomën si “Mësuese e gjuhës angleze” dhe në provimin e licencës për mësuese është vlerësuar me notën 9 (nëntë). Ankuesja shprehet se, për efekt të punësimit të saj si mësuese, ka aplikuar konform rregullave duke dorëzuar dokumentacionin e kërkuar si dhe duke marrë pjesë në provimin përkatës në portalin “Mësues për Shqipërinë” për vitin 2020. Në përfundim të procedurës së ndjekur për vlerësimin e kandidatëve, ankuesja me datë 02.09.2020 është njohur me rezultatet përfundimtare, në bazë të të cilave ka rezultuar e renditur në vendin e 23^{-të}. Znj. B është shprehur, si më poshtë citojmë:

¹Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD, i ndryshuar me ligjin nr. 124/2020.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD.

“ - Shpërndarja e vendeve të punës së mësuesve bëhet duke i ofruar vendin e punës fillimisht aplikantit të vendit të parë dhe në rast të refuzimit nga ana e tij, ai vend i ofrohet aplikantit pasardhës në renditje, duke vazhduar deri sa ky vend të pranohet nga një aplikant;

- Diferenca e pikëve ndërmjet aplikantëve në renditjen e portalit është shumë e vogël, në disa raste edhe 0,2 pikë;

Kjo do të thotë që çdo shumë pikësh, sado e vogël, është e asaj rëndësie sa mund të ndryshojë renditjen e aplikantit në portal dhe për rrjedhojë edhe oferta për punë i jepet përpara atij. Po ashtu, renditja në portal ka rëndësi pasi mund të ndodhë që një vend pune në një zonë të largët të refuzohet nga shumica e aplikantëve dhe të merret nga i interesuari ”.

Ankuesja, në kontekst të analizimit të mënyrës mbi të cilën bëhet përlllogaritja e pikëve në vlerësimin e aplikantëve, ka parashtruar se, Udhëzimi nr. 13, datë 22.05.2019 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në Institucionet Arsimore Publike të Arsimit Parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë””, në dy prej pikave të Shtojcës nr. 2, të tij, bën një diferencim jo të drejtë dhe pengon në shfaqjen e dijeve arsimore të aplikuesit, cituar si më poshtë:

“ Së pari, provimi i licencës së mësuesit vlerësohet me një pikë, pavarësisht faktit se çfarë note është marrë në këtë provim. Në pikën 1, të kësaj Shtojce, kandidatit i vlerësohet në mënyrë të detajuar nota mesatare e studimeve të larta dhe ky arsyetim është logjik dhe i drejtë, pasi një person që ka një mesatare më të lartë, nënkupton që ka dhe dije më të mëdha në fushën përkatëse dhe rrjedhimisht dhe përgatitje më të madhe në këtë drejtim. Por për analogji, një gjë e tillë nuk merret në konsideratë për notën e provimit të licencës, edhe pse ky provim vlerëson njohuritë e përgjithshme në të gjithë gamën e lëndëve që janë studiuar dhe është një vlerësim më i plotë dhe i detajuar. Bazuar në këtë vlerësim, trajtohen njëlloj si personat që vlerësohen me notën 5 (pesë) dhe ata që vlerësohen me notën 10 (dhjetë). Nëse dy aplikantë për mësues kanë nota të ndryshme në licencë, atëherë nuk kanë pse të trajtohen në mënyrë të barabartë. Një trajtim i tillë, duke mos vlerësuar në detaje një provim kaq të rëndësishëm, redukton mundësitë për një vlerësim të drejtë të aplikantit. Nga ekspertët përkatës duhet bërë vlerësimi i drejtë lidhur me mënyrën e pikëzimit për provimin e licencës dhe jo të vlerësohet më 1 (një) pikë, si aplikanti që merr notën 5 (pesë) dhe ai që merr notën 10 (dhjetë). Në rastin konkret, jam vlerësuar me notën 9 (nëntë) dhe me një vlerësim me pikë referuar kësaj note, do kisha sasi më të madhe pikësh dhe rrjedhimisht edhe një pozicion më të lartë në renditjen e aplikantëve në portal.

Së dyti, në pikën 3, të kësaj Shtojce, jepet vlerësimi i detajuar i dëshmisë së gjuhëve të huaja. Konkretisht parashikohet:

- a) Gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL-të publike = 2 pikë.
- b) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B1 = 2 pikë.
- c) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B2 = 4 pikë.

Ky ndryshim pikësh është i konsiderueshëm dhe reflektohet në mënytë të ndjeshme në pikët totale të aplikantit. Sasia prej dy pikësh mund të bëjë zhvendosjen me 4-5 pozicione në renditje dhe kjo nënkupton shtim ose reduktim të mundësive për të marrë ofertën e punës. Diferenca prej 2 pikësh mes aplikantëve që kanë gjuhën e huaj të mbrojtur në IAL-të publike dhe atyre që kanë gjuhën e

huaj të mbrojtur me testim ndërkombëtar, bën që unë të trajtohem ndryshe në kushte të njëjta, vetëm për faktin se kam mbrojtur gjuhën e huaj në IAL-të publike të vendit tim, ndërsa ata që e kanë të mbrojtur me testim ndërkombëtar kanë privilegjin të marrin më shumë pikë. Pra, mes dy personave që kanë aplikuar për t'u punësuar si mësues të gjuhës angleze, dhe të dy kanë mbrojtur dhe një gjuhë tjetër të huaj, MASR privilegjon atë që e ka të mbrojtur me testim ndërkombëtar duke i dhënë dyfishin e pikëve, pavarësisht se notën në licencë tjetri mund ta ketë më të lartë. Pra, për një element dytësor siç është rasti sipërcituar, vlerësimi me një sasi kaq të madhe pikësh dhe me një diferencim jologjik të IAL-ve publike shqiptare është jo proporcional. Në këtë rast, kemi të bëjmë me një vlerësim jo objektiv dhe të paarsyeshëm të dhënies së pikëve për mbrojtjen e gjuhës së huaj, jo vetëm në krahasim me atë të mbrojtur në IAL-të publike shqiptare, por edhe si sasi totale të pikëve”.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të urdhërojë MASR të kryejë ndryshimet e duhura në Shtojcën 2, të Udhëzimit nr. 13, datë 22.05.2019 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në Institucionet Arsimore Publike të Arsimit Parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë””, mbi vlerësimin e notës së licencës dhe pikëve të gjuhës së huaj.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së⁴, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, i ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

⁴Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Njëpërmjet shkresës me nr. 1700/1 prot., datë 18.12.2020 nga ana e KMD i është kërkuar informacion dhe dokumentacion provues Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), lidhur me pretendimin e ankueses.
- Njëpërmjet shkresës me nr. 3669/1 prot, datë 07.01.2021, Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP) pranë MASR, ka dërguar parashtrimet e veta dhe ka argumentuar si më poshtë vijon:

“Në lidhje me pikën e parë, sqarojmë se pika 1, e shtojcës 2, të Udhëzimit nr. 13, datë 22.05.2019 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në Institucionet Arsimore Publike të Arsimit Parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë””, i ndryshuar, përcakton pikët që merr kandidati i pajisur me licencë për ushtrimin e profesionit të mësuesit dhe kjo është bërë për të vlerësuar edhe kandidatët e sapo diplomuar, të cilët nuk kanë vjetërsi pune në arsim. Ky vlerësim është i njëjtë për të gjithë aplikantët dhe nuk ka asnjë element veçues, përjashtues apo diferencues midis aplikantëve. Shkallëzimi i pikës së notës paraqet pamundësi në procedurat standarde të vlerësimit nga Komisionet që ngrihen për vlerësimin e dosjeve në çdo Drejtori Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe për këtë arsye licenca për ushtrimin e profesionit të mësuesit vlerësohet me 1 (një) pikë, jo të shkallëzuar. Në këtë rast nuk mund të bëhet analogji me pikët e notës mesatare, pasi shumica e pikëve për këtë kriter është shumë herë më e madhe. Licenca për ushtrimin e profesionit të mësuesit është një e drejtë për të ushtruar këtë profesion dhe nuk mund të përdoret si argument nota për të përfutur nga pikët, siç pretendon znj. B, pasi ndryshimet me 0,2 pikë në renditjen finale nuk vijnë vetëm nga pikët e licencës por nga shumë tregues të tjerë sipas përlllogaritjeve të gjithë elementëve vlerësues të përcaktuar në këtë udhëzim.

Në lidhje me pikën e dytë, sqarojmë se, klasifikimi i aftësive gjuhësore dhe niveleve të njohjes së gjuhëve, në referencë të pikëve të testeve të ndryshme ndërkombëtare, shërben si standard për njohjen e gjuhëve të huaja dhe testeve ndërkombëtare përkasëse në Shqipëri, sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimit në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, pra, njihen vetëm certifikatat e lëshuara ndërkombëtarisht. Kjo mënyrë vlerësimi, në lidhje me nivelin e zotërimit të gjuhës së huaj është konceptuar e tillë, për të bërë diferencën dhe në këtë proces çdo kandidat ka të drejtë dhe i jepet mundësia për të dëshmuar nivelin e njohurive për të pasur më pas një dokument njohje gjuhe bazuar tërësisht në aftësitë e tij. Gjithsesi për të mos u hequr mundësinë edhe atyre aplikantëve që e kanë mbrojtur gjuhën e huaj në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja pranë Universitetit të Tiranës, edhe pse nuk njihet sipas

Udhëzimit nr. 52, është gjykuar të vlerësohet me 2 (dy) pikë. Dhe në këtë rast pikët që përfitohen janë qartësisht të shprehura paraprakisht dhe trajtojnë në mënyrë të barabartë çdo kandidat në garë”.

Lidhur me pretendimin e ankueses për ndryshime në Udhëzimin nr. 13, datë 22.05.2019 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në Institucionet Arsimore Publike të Arsimit Parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë””, i ndryshuar, DPAP, ka sqaruar se, procedurat e punësimit të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar udhëhiqen nga parimet e ligjshmërisë, të përgjegjshmërisë, si dhe nga vlerat e profesionalizmit, transparencës, meritës, të drejtës për zgjedhjen e institucionit arsimor, barazisë dhe interesit më të lartë të nxënësve. Në funksion të interesit më të lartë të nxënësve, kandidatët që aspirojnë për të pasur një pozicion pune në sistemin arsimor parauniversitar duhet të dëshmojnë aftësitë e tyre profesionale duke kaluar me sukses të gjitha fazat e përcaktuara në udhëzimin sipërcituar, dhe në këtë kontekst, DPAP shprehet se nuk përbën diskriminim kur kërkohet nga kandidatët që për një pozicion pune të dëshmojnë vetëm aftësitë profesionale, pa asnjë dallim.

DPAP mban qëndrimin se, në fazat e konkurimit në portalin “Mësues për Shqipërinë” bazuar në përcaktimet e udhëzimit, objekt shqyrtimi pranë KMD-së, nuk ka dallime, përjashtime, kufizime apo preferenca, dhe për pasojë nuk ka pengesa në bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga legjislacioni në fuqi.

2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës së E. B, Komisioneri me datë 05.03.2021⁵ realizoi një seancë dëgjimore me palët në proces.

Në seancë u paraqit vetëm pala kundër së cilës është paraqitur ankesa, MASR, përfaqësuar nga I. A dhe E. A, bazuar në Autorizimin nr. 1239/1 prot., datë 05.03.2021 të MASR-së.

Gjatë seancës dëgjimore, bazuar në kërkesën e përfaqësueseve të MASR-së, u dakordësua që dokumentacioni i kërkuar paraprakisht nëpërmjet shkresës me nr. 360 prot., datë 23.02.2021, të Komisionerit, të depozitohet pranë KMD-së në vijim.

- Ndërkaq, në vijim të seancës dëgjimore, MASR, nëpërmjet shkresës me nr. 1239/2 prot., datë 25.03.2021 njohu Komisionerin me parashtrimet e saj. Bazuar në shkresën sipërcituar, rezulton se MASR mban të njëjtin qëndrim dhe parashtron të njëjtat argumenta me ato të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP) pranë MASR-së⁶.

⁵ Referuar “Njoftimit për seancë dëgjimore” me nr. 360 prot., datë 23.02.2021, të Komisionerit.

⁶ Referuar shkresës me nr. 3669/1 prot, datë 07.01.2021, të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP) pranë MASR.

3. Njëpërmjet shkresës me nr. 360/2 prot., datë 28.04.2021 të Komisionerit, MASR-së i është kërkuar informacion më i detajuar lidhur me mënyrën e konvertimit në pikë të dëshmisë së njohjes të gjuhës së huaj, të mbrojtur pranë universiteteve shqiptare⁷.

➤ Njëpërmjet shkresës me nr. 2426/1 prot., datë 14.05.2021 MASR ka argumentuar se, kriteri i njohjes së njërës prej gjuhëve të huaja, të përcaktuara sipas Udhëzimit nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në IAL” , të ndryshuar, është kriter hyrës, pra kriter pranimi në programin e ciklit të dytë të studimeve. Bazuar në përcaktimet e bëra në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Udhëzimin nr. 52/2015, sipërcituar; parashikohet se kandidatët, të cilët aplikojnë për t’u pranuar në programe studimi të ciklit të dytë apo të tretë në IAL, duhet të kenë nivel të njohjes së njërës prej gjuhëve të huaja, sipas përcaktimeve të udhëzimit sipërcituar.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm

Në këtë rubrikë të Vendimit është vlerësuar trajtimi i ankueses, si pasojë e zbatimit të pikave 2 dhe 3 të Shtojcës 2, të Udhëzimit nr. 13, datë 22.05.2019 “Për procedurat e pranimet e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në Institucionet Arsimore Publike të Arsimit Parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë””, të ndryshuar, të MASR-së.

A/a) Përsa i takon pretendimit se liçenca e mësuesit e vlerësuar me një pikë, dhe jo e pikëzuar, bazuar në notën e marrë në këtë provim, vë në pozita të pafavorshme ankuesen/kandidatët e vlerësuar me notë të lartë, krahasuar me ata të vlerësuar me notë të ulët, pasi të gjithë trajtohen njëjloj, në mënyrë të barabartë,

Komisioneri vëren se:

Pika 2, germa a) e Shtojcës 2, të Udhëzimit nr. 13, datë 22.05.2019 “Për procedurat e pranimet e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në Institucionet Arsimore Publike të Arsimit Parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë””, të ndryshuar, ka përcaktuar tek ndarja e dytë e saj “Shkallët e kualifikimit dhe licencimi” se:

“ a) Në rast se kandidati zotëron provimin e licencës vlerësohet me 1 (një) pikë”.

- ⁷ Specifikisht, nëse: “Dëshmia e njohjes së gjuhës italiane, e mbrojtur pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës, njihet si gjuhë e huaj e mbrojtur në kuadër të përfundimit të studimeve universitare të ciklit të parë apo të dytë? Si dhe, nëse kjo dëshmi është e njëjtlefshme me dëshminë e gjuhës së huaj të mbrojtur me testim ndërkombëtar të nivelit B1 apo B2?”

Në pamje të parë, nga leximi i kësaj dispozite, vërehet se ajo trajton njëloj, në mënyrë të padiferencuar të gjithë kandidatët që zotërojnë provimin e licencës së mësuesisë.

Por, nga na tjetër, referuar vlerësimin të njohurive nëpërmjet zotërimit të licencës, evidentohet se, ajo bën një vlerësim të detajuar të njohurive të përgjithshme për të gjitha lëndët që janë studiuar, nga kandidati, i cili është i pikëzuar dhe i konvertuar në notë. Pra, vetë licenca e kandidatëve vlerësohet me notë, dhe në varësi të rezultatit të tyre në këtë testim njohurish ajo është e ndryshme, duke filluar nga nota 5 (pesë) e deri në 10 (dhjetë).

Ankuesja në rastin konkret, është vlerësuar me notën 9 dhe ka pretenduar se trajtohet njëloj me kandidatët që janë vlerësuar me notën 5 (pesë) në zotërimin e licencës.

Pra, Komisioneri, vëren se, *a prima facie*, pika 2/a) e Shtojcës 2, të Udhëzimit sipërcituar, trajton në mënyrë të padiferencuar⁸ të gjithë kandidatët që zotërojnë dëshminë e licencës.

A/b) Përsa i takon pretendimit se, gjuha e huaj e mbrojtur në IAL Publike vlerësohet në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshme, krahasuar me atë të mbrojtur me testim ndërkombëtar.

Pika 3 e Shtojcës 2, të Udhëzimit nr. 13, datë 22.05.2019 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në Institucionet Arsimore Publike të Arsimit Parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë””, të ndryshuar, ka përcaktuar se vlerësimi i detajuar i dëshmisë së gjuhëve të huaja është si më poshtë cituar:

- a) Gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL-të publike = 2 pikë.
- b) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B1 = 2 pikë.
- c) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B2 = 4 pikë”.

Në pamje të parë, nga leximi i pikës sa më sipër, vërehet se ajo:

- Trajton njëloj, në mënyrë të barabartë, gjuhën e huaj të mbrojtur në IAL-të publike, me atë të mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B1, me 2 pikë.
- Trajton në mënyrë të pabarabartë e të diferencuar, gjuhën e huaj të mbrojtur në IAL-të publike, me atë të mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B2, me 4 pikë.

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të pabarabartë apo të pafavorshme, sikurse ka pretenduar, ai krahasohet me persona të tjerë, të ndodhur në një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të.

Në këtë kontekst, për të analizuar sa më sipër, Komisioneri vëren se:

Vlerësimi dhe klasifikimi i aftësive gjuhësore dhe niveleve të njohjes së gjuhëve, në referencë të pikëve të testeve të ndryshme ndërkombëtare shërben si standard për njohjen e gjuhëve të huaja dhe testeve ndërkombëtare përkatëse në Republikën e Shqipërisë, dhe bazohet në përcaktimet e

⁸ Lidhur me këtë fakt, Komisioneri në nënndarjen C, të Vendimit, do të analizojë nëse një trajtim i tillë ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

bëra në Udhëzimin nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”.

Referuar këtij Udhëzimi, njihen vetëm certifikatat e lëshuara ndërkombëtarisht. Kështu, në pikat 1,2,3,4 të tij, MASR ka parashikuar në mënyrë të detajuar, duke urdhëruar shprehimisht:

“Përcaktimin e niveleve dhe testeve ndërkombëtare të 5 (pesë) gjuhëve të huaja, përkatësisht: gjuhës angleze, gjuhës frënge, gjuhës gjermane, gjuhës italiane dhe gjuhës spanjolle, kandidatët, të cilët aplikojnë për t’u pranuar në programe studimi të ciklit të dytë apo të tretë, në institucionet e arsimit të lartë, duhet të kenë nivel të njohjes së njërës prej gjuhëve të huaja, sipas përcaktimeve në këtë Udhëzim.

Klasifikimi i aftësive gjuhësore dhe niveleve të njohjes së gjuhëve, bëhet sipas tabelës bashkëlidhur këtij udhëzimi, në referencë të pikëve të testimeve të ndryshme ndërkombëtare dhe shërben si standard për njohjen e gjuhëve të huaja dhe testeve ndërkombëtare në Shqipëri.

Për pranimin në programet e studimeve të ciklit të dytë, kandidati duhet të ketë njohje të gjuhës së huaj, ndërmjet nivelit B1 dhe C1.

Kandidati që aplikon për t’u pranuar në programe të ciklit të dytë apo të tretë në IAL, duhet të ketë certifikime dhe rezultate të testimeve ndërkombëtare për nivelet e njohjes së gjuhëve të huaja”.

Bazuar në sa më lart, kandidati që aplikon për t’u pranuar në programe studimi të ciklit të dytë apo të tretë në Institucionin e Arsimit të Lartë, duhet të ketë certifikime dhe rezultate të testimeve ndërkombëtare për nivelet e njohjes së gjuhëve të huaja, dhe kriteri i njohjes së njërës prej gjuhëve të huaja, shërben si kriter hyrës/pranimi në programin e ciklit të dytë të studimeve.

Sipas përcaktimeve të këtij Udhëzimi, kandidatët duhet të disponojnë dokumente të njohjes së gjuhës së huaj vetëm nga testet e certifikuara nga MASR, dhe në asnjë rast nuk bëjnë pjesë certifikatat e lëshuara nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës, bazuar në faktin se përcaktimi i testeve është bërë në mbështetje të: Kuadrit të Referencave për Gjuhët të krijuar nga Këshilli i Europës (2001), Kuadrit të Përbashkët European të Referencave për Gjuhët, si dhe në bashkëpunim me Ambasadat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Britanisë së Madhe, Gjermanisë, Francës, Italisë dhe Spanjës të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Bazuar në Udhëzimin sipërcituar, gjuha e huaj e mbrojtur pranë IAL-ve, nuk është parashikuar në listën e niveleve të njohjes së gjuhëve të huaja dhe testimeve ndërkombëtare. Vlerësimi i kandidatëve bazuar në testet ndërkombëtare, i jep mundësinë atyre për të pasur në vijim një dokument që dëshmon njohjen e gjuhës së huaj, bazuar në zotërimin e niveleve të ndryshme të njohurive të saj.

Për të mos u hequr mundësinë atyre aplikantëve që kanë mbrojtur gjuhën e huaj në IAL-publike shqiptare, pavarësisht faktit se një dëshmi e tillë nuk njihet sipas Udhëzimit nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, MASR, ka

grykuar të vlerësojë me 2 pikë të gjithë kandidatët që u nënshtrohen parashikimeve të pikës 3, të Shtojcës 2, të këtij Udhëzimi.

Komisioneri konstaton se, për vlerësimin e këtyre kandidatëve, pavarësisht se nuk parashikohet në mënyrë eksplicite në Udhëzim, MASR ka përdorur analogjinë e vlerësimit të kandidatëve që kanë gjuhën e huaj të mbrojtur me testim ndërkombëtar sipas nivelit B1=2 pikë. Pra, duke vlerësuar se kanë nivel njohjeje dhe aftësish të njëjta të gjuhës së huaj, si kandidatët që kanë dëshmi të njohjes së gjuhës së huaj të IAL-ve shqiptare, ashtu dhe kandidatët që kanë dëshmi njohjeje të gjuhës së huaj të mbrojtur me testim ndërkombëtar sipas nivelit B1.

Nga analogjia e përdorur më sipër në Vendim, niveli i njohurive të gjuhës së huaj të mbrojtur në IAL është vlerësuar se është i njëjtë me nivelin e njohurive të gjuhës së huaj të mbrojtur me testim ndërkombëtar nivel B1. Udhëzimi i pikëzon me 2 pikë të dyja, ndërsa me 4 pikë vlerëson nivelin B2 të gjuhës së huaj të mbrojtur me testim ndërkombëtar.

Për rrjedhojë, pretendimi i ankueses për t' u vlerësuar me 4 (katër) pikë nuk është i drejtë, pasi nuk është e njëjta situatë krahasimore. Për sa kohë janë nivele të ndryshme të njohurive të gjuhës së huaj, nuk mund të vlerësohen njëllë, dhe as mund të ketë trajtim të njëjtë në këto kushte. Testimi ndërkombëtar bëhet me nivele nga B1-C1, dhe bazohet pikërisht në rritjen progresive të shkallës së njohurive dhe aftësive gjuhësore nga njëri nivel tek tjetri (duke filluar nga niveli B1).

Kjo për faktin se, testimi ndërkombëtar njihet ndërkombëtarisht dhe ka peshë më të madhe njohjeje në tregun e punës, përfshirë edhe atë të vendeve të BE⁹, ndërsa dëshmia e njohjes së gjuhës së huaj të lëshuar nga IAL shqiptare njihet dhe vlerësohet në kontekst të krijimit të një mundësie për punësim në nivel kombëtar.

Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se, nuk jemi para një trajtimi të ndryshëm, që pika 3 e Shtojcës 2, të këtij Udhëzimi u bën kandidatëve që zotërojnë një dëshmi të njohjes së gjuhës së huaj të lëshuar nga IAL dhe kandidatëve që gjuhën e huaj e kanë të mbrojtur me testim ndërkombëtar, pasi nuk jemi në të njëjtën situatë dhe në kushte të njëjta.

Lidhur me pretendimin e ankueses për trajtim të pabarabartë e të pafavorshëm të saj se ka një dëshmi të gjuhës së huaj të mbrojtur në IAL-të publike, krahasuar me kandidatët që kanë dëshmi të gjuhës së huaj të mbrojtur me testim ndërkombëtar, Komisioneri vlerëson se:

Pika 3 e Shtojcës 2, të Udhëzimit nr. 13, datë 22.05.2019 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në Institucionet Arsimore Publike të Arsimit Parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë””, të ndryshuar, nuk e vë atë në pozitat e trajtimit të pabarabartë e të pafavorshëm, pasi bëhet fjalë për kushte dhe situata krahasimisht të ndryshme.

⁹ Vendeve të BE ku njihet ky testim i gjuhës së huaj.

Në këtë kontekst, në mungesë të një trajtimi të pabarabartë dhe të pafavorshëm, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e MASR-së, për shkakun e pretenduar nga ankuesja, lidhur me pikën 3, të Shtojcës 2, të Udhëzimit objekt analizimi.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2¹⁰, të ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

“Gjendja arsimore” si shkak diskriminimi, nënkupton nivelin individual të arsimit, arritjet në arsim, aftësitë, certifikatat dhe mundësitë në lidhje me arsimin të cilat një person posedon.¹¹

Referuar nenit 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ky shkak i pretenduar nga ankuesja konsiderohet si shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD, si dhe subjekti ankues ka depozituar prova/dokumentacion, i cili faktori se e mbart atë:

- Kopje të licencës për ushtrimin e profesionit të mësuesit në profilin “gjuhë angleze”, me numër 1601000640, datë 25.10.2016.
- Kopje e dëshmisë të njohjes të gjuhës së huaj të mbrojtur në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja/Universiteti i Tiranës, me nr. 20113 regj., datë 18.05.2019.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.

Për të vërtetuar faktin se ankuesja është ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e MSAR-së, duhet të ekzistojë një lidhje objektive shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe trajtimit të padrejtë, të

¹⁰ “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

¹¹ Shih linkun në faqen zyrtare të KMD-së: <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

pabarabartë apo të pafavorshëm të saj. Në parim, kjo linjë ndiqet për rastet kur pretendohet diskriminim i drejtëpërdrejtë, mirëpo, ankuesja ka pretenduar se diskriminohet në mënyrë të tërthortë nga akti/ Udhëzimi i nxjerrë nga MASR.

LMD ka parashikuar se: “ *“Diskriminim i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme, për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë”*.

Edhe e drejta e BE-së edhe jurisprudenca e GJEDNJ-së pranojnë se diskriminimi mund të rezultojë jo vetëm nga trajtimi i ndryshëm i njerëzve në situata të njëjta, por gjithashtu duke ofruar të njëjtin trajtim për njerëzit në situata të ndryshme. Ky i fundit quhet diskriminim “i tërthortë”, sepse nuk është trajtimi që ndryshon por janë më tepër pasojat e atij trajtimi, që do të ndjehen ndryshe nga njerëzit me karakteristika të ndryshme. Ose, në të kundërt, duhet të provojë se, nëse një trajtim i tillë ka ndodhur, ai ka një justifikim të arsyeshëm objektiv.

Pika 2, germa a) e Shtojcës 2, të Udhëzimit nr. 13, datë 22.05.2019 “*Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në Institucionet Arsimore Publike të Arsimit Parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”*”, të ndryshuar, ka përcaktuar tek ndarja e dytë e saj “Shkallët e kualifikimit dhe licencimi” se:

“ a) Në rast se kandidati zotëron provimin e licencës vlerësohet me 1 (një) pikë”.

Në pamje të parë, nga leximi i kësaj dispozite, vërehet se ajo trajton njëlloj, në mënyrë të padiferencuar të gjithë kandidatët që zotërojnë provimin e licencës së mësuesisë.

Por, nga na tjetër, referuar vlerësimit të njohurive nëpërmjet zotërimit të licencës, evidentohet se, ajo bën një vlerësim të detajuar të njohurive të përgjithshme për të gjitha lëndët që janë studiuar, nga kandidati, i cili është i pikëzuar dhe i konvertuar në notë. Pra, vetë licenca e kandidatëve vlerësohet me notë, dhe në varësi të rezultatit të tyre në këtë testim njohurish ajo është e ndryshme, duke filluar nga nota 5 (pesë) e deri në 10 (dhjetë).

Ankuesja në rastin konkret, është vlerësuar me notën 9 dhe ka pretenduar se trajtohet njëlloj me kandidatët që janë vlerësuar me notën 5 (pesë) në zotërimin e licencës.

Kodi i Procedurës Administrative¹² dhe ligji 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”¹³, i ndryshuar, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast MASR-së.

¹²Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: “*Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose*

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Pasi personi që pretendon diskriminim krijon një prezumim të diskriminimit të tërthortë nga akti nënligjor i kundërshtuar (diskriminimi prima facie), barra më pas kalon tek subjekti/organi public që e ka nxjerrë atë, i cili duhet të tregojë në rastin konkret, se trajtimi barabartë i kandidatëve, në vlerësimin e njëjtë të licencës, për të gjithë, me një pikë, pavarësisht notës së marrë, ndjek një qëllim të ligjshëm dhe ka një justifikim të arsyeshëm.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni dhe i janë ofruar mundësitë që të japë shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Lidhur me sa më lart, MASR ka mbajtur qëndrimin se, ky vlerësim është i njëjtë për të gjithë aplikantët dhe nuk ka asnjë element veçues, përjashtues apo diferencues midis aplikantëve. Shkallëzimi i pikës së notës paraqet pamundësi në procedurat standarde të vlerësimit nga Komisionet që ngrihen për vlerësimin e dosjeve në çdo Drejtori Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe për këtë arsye licenca për ushtrimin e profesionit të mësuesit vlerësohet me 1 (një) pikë, jo të shkallëzuar.

Në këtë kontekst, Komisioneri do të vlerësojë nëse një trajtim i tillë është i përligjur, i arsyeshëm dhe i justifikuar objektivisht.

Vendosja e këtij kriteri është e përligjur, pasi është e parashikuar dhe e përcaktuar në aktin nënligjor, që është Udhëzimi i MASR-së, objekt analizimi.

Lidhur me justifikimin objektiv të vendosjes së këtij kriteri neutral/vetëm me një pikë, të njëjtë për të gjithë kandidatët, Komisioneri ka bërë analizën më poshtë.

Lidhur me pretendimin e ankueses, se licenca duhet pikëzuar sipas notës së marrë, duke ndjekur për analogji vlerësimin e bërë për notën mesatare të studimeve të larta, të pikëzuar në varësi të notës së marrë, Komisioneri ka vlerësuar se, nuk mund të përdoret analogjia në përlllogaritjen e pikëzuar të notës së licencës njëlloj si për përlllogaritjen e pikëve të notës mesatare. Shuma e

organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej tij”.

¹³ Neni 33, pika 7/1 e Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikon: *“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”*

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

pikëve për kriterin e notës mesatare është disa herë më e madhe dhe shkon në logjikën e vlerësimit të diplomës si dëshmi e nivelit të njohurive të përfituara nga mësuesi.

Ligji nr. 10081, datë 23.02.2009 *“Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1/gj ka përcaktuar se: *“Licencë” është akti administrativ, që i njeh titullarit të saj të drejtën të fillojë e të ushtrojë tipin e veprimtarisë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të”*.

Neni 8, pika 4, i këtij Ligji cilëson se: *“Çdo kërkues, që plotëson kriteret e licencimit apo autorizimit, fiton të drejtën që ta ushtrojë atë veprimtari apo, përkatësisht, ta kryejë atë veprim”*.

Nga interpretimi i nenit 9, të po këtij Ligji, rezulton se, vlerësimi i plotësimit të kriterëve kualifikuese është pjesë e një procesi lejimi ose një procesi paraprak licencimi. Në këtë rast, licencimi është kusht paraprak, i domosdoshëm për lejimin.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri, vlerëson se, kriteri i licencimit shërben si kusht paraprak dhe i domosdoshëm për ushtrimin e profesionit të mësuesisë, dhe zotërimi i këtij dokumenti i njeh kandidatit/mësuesit, të drejtën që ai të fillojë të ushtrojë veprimtarinë në profesionin e tij.

Parë në këtë kontekst, Komisioneri, gjykon se, pretendimi i ankueses se vlerësimi i licencës për ushtrimin e profesionit të mësuesisë duhet të jetë i pikëzuar dhe duhet ndjekur analogjia e vlerësimit të pikëve të notës mesatare të diplomës së studimeve universitare, nuk qëndron dhe është i paarsyeshëm.

Licenca për ushtrimin e profesionit, (për analogji njëllor si licencat e zotëruara për ushtrimin e profesioneve të tjera të rregulluara me ligj) është një e drejtë ligjore që i shërben zotëruesit të saj, thjesht për të ushtruar këtë profesion dhe në këtë logjikë nuk qëndron pretendimi i ankueses se nota/pikët e marra në mbrojtjen e saj, duhet të përlllogariten të pikëzuara njëllor si pikët e notës mesatare të dëshmisë së përfundimit të studimeve në arsimin e lartë.

Zotërimi dhe përvetësimi i njohurive dhe aftësive profesionale të mësuesit gjatë ushtrimit të profesionit të tij, dëshmohet nëpërmjet zotërimit të kategorive të kualifikimit, siç janë: kategoria e parë (mësues mjeshtër), kategoria e dytë (mësues specialist) dhe kategoria e tretë (mësues i kualifikuar).

Në vlerësimin tërësor të kriterëve të përcaktuara në pikën 2/a), të Shtojcës 2, të Udhëzimit Udhëzimit nr. 13, datë 22.05.2019 *“Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në Institucionet Arsimore Publike të Arsimit Parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”*”, të ndryshuar, të MASR-së, Komisioneri vlerëson se, vlerësimi i pikëzuar i kandidatëve përsa i takon shkallëve të kualifikimit dhe licencimit të tyre, si shumatore e të dyjave, është i arsyeshëm, i justifikuar dhe në përputhje me kualifikimet e tyre.

Vlerësimi i kandidatit me vetëm 1 (një) pikë, sipas përcaktimit të bërë në pikën 2/a) të Shtojcës 2, të Udhëzimit sipërcituar, lidhur me zotërimin e licencës për ushtrimin e profesionit të mësuesisë është i arsyeshëm dhe ndjek një qëllim të ligjshëm dhe objektiv në përputhje me parashikimet dhe

frymën e ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, e akteve nënligjore të tij, si dhe ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më lart, qëllimi i vendosjes së këtij kriteri (neutral/vlerësim me një pikë për të gjithë kandidatët) është i ligjshëm, i arsyeshëm dhe i përshatshëm për realizimin e vlerësimit të kandidatëve, bazuar në Udhëzimin nr. 13, datë 22.05.2019 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në Institucionet Arsimore Publike të Arsimit Parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë””, të ndryshuar.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se, ankuesja nuk i është nënshtruar trajtimit të padrejtë për sa i takon vlerësimit të dosjes së saj, bazuar në pikën 2/a) të Shtojcës 2, të Udhëzimit objekt analizimi.

Në përfundim, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me diskriminim të tërthortë të ankueses, nëpërmjet këtij Udhëzimi, për shkakun e pretenduar prej saj.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/7, nenin 32, pika 1/a), si dhe nenin 33, pika 10 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të E. B, në të drejtën për punësim, për shkak të gjendjes arsimore, nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha: Punësim
Shkaku: Gjendja arsimore
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim